

FINANCA

BULETINI MUJOR | GUSHT 2025



MINISTRIA E FINANCAVE NIS PROCEDURAT E PAGESËS SË KËSTIT TË PESTË PËR TRASHËGIMTARËT E ISH TË DËNUARVE POLITIKË

Ministria e Financave ka çelur këstin e pestë për kategorinë e subjekteve përfituese joparësore (trashëgimtarë), të ish të dënuarve politikë dhe ka filluar procedurën e pagesës së këtij kësti, në bazë të Urdhrit të Ministrit të Financave Nr. 12, datë 20.08.2025. Kjo procedurë bëhet në zbatim të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", të ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 419, datë 14.01.2011, "Për miratimin e afateve

dhe të skemës së shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist", të ndryshuar. Në vijim të çeljes së fondit për këstin e pestë për trashëgimtarët e ish të dënuarve politikë, është publikuar dhe lista e parë të dosjeve në radhë për përfitimin e këstit të pestë. Në mbështetje të dokumentacionit të depozituar pranë Ministrisë përgjegjëse për financat, Drejtoria përgjegjëse për pagesat, në zbatim të bazës ligjore dhe procedurave përkatëse, realizon shpërndarjen e pagesave të këstit të radhës, duke ndjekur dhe radhën e pagesave të paguara ndër vite.

► LEXO MË SHUMË

MINISTRIA E FINANCAVE HARTON PËR HERË TË PARË BUXHETIN FAKTIK 2024 PËR QYTETARIN

Ministria e Financave ka hartuar për herë të parë Buxhetin Faktik 2024 për Qytetarin, si një dokument tërësisht të dedikuar. Ky raport përmban të dhëna mbi të ardhurat që mbliidhen nga taksat dhe burimet e tjera, por edhe për mënyrën se si paratë shpenzohen, duke u kthyer në investime e prioritet, në dobi të ekonomisë. Qëllimi i hartimit të këtij dokumenti është dhënia e një informacioni të thjeshtuar e lehtësisht të kuptueshëm nga të gjithë, mbi reformat e rëndësishme që po ndërmerren për të përmirësuar menaxhimin e

parave publike, si pjesë e udhëtimit drejt anëtarësimit në BE. Gjatë vitit 2024, Qeveria vijoi të kishte në fokus mbajtjen e një buxheti të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm, që do të thotë shpenzime të kujdesshme dhe garantimi që vendi të mos marrë shumë hua. Në vitin 2024, qeveria mblozhi 10.4% më shumë të ardhura se një vit më parë, ndërsa shpenzimet u rritën me 8.0%. Qeveria e uli deficitin buxhetor në 0.7% të PBB-së, ndërsa gjatë viteve të ardhshme, qëllimi është që deficitin mesatar të mbahet rreth 2%, duke ndjekur "rregullin e artë" - që do të thotë huamarrje vetëm për investime, jo për shpenzime të përditshme.

► LEXO MË SHUMË



DOGANAT, MINISTRI MALAJ ZHVILLON NJË VIZITË INSPEKTIMI PRANË SKANERIT TË PORTIT TË DURRËSIT

Ministri i Financave, Petrit Malaj, së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave, Genti Gazheli, zhvilluan një vizitë inspektuese pranë skanerit të Portit të Durrësit, ku gjatë tre muajve të fundit është shënuar një ulje e ndjeshme e numrit të skanimeve. Ky zhvillim ka sjellë lehtësim të dukshëm të procesit për operatorët ekonomikë dhe është mirëpritur nga shoqëritë e transportit, të cilat kanë vlerësuar reduktimin e kohës së pritjes dhe trajtimin më efikas të fluksit. Ministri Malaj vlerësoi masat e ndëmarra si të domosdoshme, pasi shkojnë drejt modernizimit të administratës doganore dhe përputhjes së proceseve të punës me standardet e Bashkimit Europian. Një doganë e shpejtë, transparente dhe e besueshme, theksoi Ministri, është thelbësore për të arritur objektivat tona dhe për t'u afruar më shpejt me standardet e BE-së.

► LEXO MË SHUMË

SKEMA KOMBËTARE E INVESTIMEVE 2025, MUNDËSI TË REJA FINANCIMI PËR SEKTORIN BUJQËSOR



Skema Kombëtare e Investimeve 2025 paraqet mundësi të reja për fermerët, agropërpunuesit dhe sipërmarrësit e sektorit të agroturizmit, përmes një pakete mbështetjeje financiare të

integruar, që përfshin grante deri në 50% të vlerës së investimeve dhe kredi të buta me norma të ulëta interesi. Aplikimet për të përfituar nga kjo skemë janë të hapura deri më 30 shtator 2025. Ministri i Financave, z. Petrit Malaj, së bashku me Ministren e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, znj. Anila Denaj, zhvilluan një vizitë në Agropikën, në Lushnje, nga ku u bënë thirrje fermerëve në të gjithë vendin që të përfitojnë nga mundësitë që ofrohen për të modernizuar dhe rritur kapacitetet e bujqësisë shqiptare. Gjatë kësaj vizite, Ministrat Malaj dhe Denaj nënvizuan rëndësinë e këtij programi për rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare dhe për zhvillimin e mëtejshëm të sektorëve të bujqësisë dhe agroturizmit.

► LEXO MË SHUMË



ICS2 – SISTEMI I RI I KONTROLLIT TË IMPORTIT NË BE – NJË HAP PËRPARA PËR SIGURINË DHE EFIKASITETIN DOGANOR!

Bashkimi Evropian ka nisur zbatimin e sistemit të ri Import Control System 2 (ICS2), një platformë moderne që synon të përforcojë kontrollin doganor përpara mbërritjes së mallrave në territorin e BE-së. Çfarë sjell ICS2? Raportim më i hershëm dhe më i detajuar i mallrave nga të gjithë operatorët ekonomikë; Rritje të sigurisë në kufi dhe luftë më të fortë ndaj

kontrabandës; Zëvendësim i sistemit të vjetër ICS1, duke përfshirë të gjitha mënyrat e transportit: ajror, detar, rrugor e hekurudhor. Nga 1 shtatori 2025, ICS2 do të jetë sistem i detyrueshëm për të gjithë operatorët ekonomikë që tregtojnë me BE-në – nëpërmjet transportit ajror, detar, rrugor apo hekurudhor. Operatorët ekonomikë që tregtojnë me BE-në duhet të sigurojnë: Numrin EORI; Sisteme të përditësuara IT; Deklarime të sakta dhe në kohë të të dhënave të ngarkesës.

► LEXO MË SHUMË